

Në bazë të nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacion dhe sponsorizim në veprimtaritë publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.47/06, 86/08, 51/11, 28/14 dhe 153/15), neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 17 i Rregullores për punë të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr. 01-3732/1 datë 29.7.2019, për arsye të Kërkesës për donacion për Laboratorin e Raportimit Investigativ - LRI Shkup, nr ynë.ark.0503-33/1 datë 1.2.2024 dhe Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë ark.nr.0201-234/2 datë 15.1.2024, Drejtori i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele miratoi si vijon:

VENDIM

për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Asociacionin e qytetarëve LABORATORIT TË RAPORTIMIT INVESTIGATIV - LRI Shkup

1. I JIPET ndihma financiare - donacion Asociacionit të qytetarëve Laboratorit të Raportimit Investigativ - LPI Shkup në vlerë prej 5.000.000,00 (pesë milionë) denarë , me qëllim të realizimit të iniciativave të ardhshme kërkimore, rritjen e vëllimit dhe cilësisë së përmbajtjeve që i prodhon, ku fokusi i të cilit është lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër dezinformimit, mbështetje në punën e saj për përmirësimin e tregut mediatik dhe krijimin e stafit shtesë që do të prodhojë përmbajtje sipas standardeve më të larta profesionale ndërkombëtare, si dhe në zbatimin e modelit inovativ të tregimit multimedial në kërkime cilësore dhe të pavarura, që do të çojë në rritjen e besimit në media dhe përmirësimin e arsimimit mediatik në vend, dhe këtë nëpërmjet raportimeve për tema të rëndësishme për qytetarët, të cilat do t'i ndihmojnë ata të marrin vendime të informuara – propagandë politike gjatë kohës së zgjedhjeve dhe sundimit të së drejtës.

LRI Shkupi detyrohet që t'i përdorë mjetet e dhëna financiare ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në paragrafin (1) të kësaj pike.

2. Mjetet financiare nga pika 1 e këtij vendimi janë paraparë në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024 dhe pagesa kryhet në llogarinë e LRI Shkup: 300-0000041683-20, depozitues i Bankës Komerciale SHA Shkup, me numër tatimor 4032018536475.

3. Për ndihmën e dhënë financiare - donacion nga pika 1 i këtij vendimi, lidhet kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (në tekstin e mëtejme: Agjencia) dhe Asociacionit të qytetarëve LABORATORIT TË RAPORTIMIT INVESTIGATIV - LRI Shkup (në tekstin e mëtejme: LRI Shkup) , e cila hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

4. Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediale Audio dhe Audiovizuale.

A r s y e t i m

Agjencisë i është dorëzuar kërkesë për donacion nga Asociacioni i qytetarëve LABORATORI I RAPORTIMIT INVESTIGATIV - LRI Shkup, nr ynë ark.0503-33/1 datë 2.1.2024, me dhënien e të cilit Agjencia do të ofrojë ndihmë dhe mbështetje për realizimin e projekteve të saj në të ardhmen për iniciativat kërkimore. Gjithashtu, me donacionin Agjencia do të kontribuojë dhe në përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara të LRI Shkup, përfshirë këtu dhe: promovimin e lirisë së mediave, rritjen e ndikimit të gazetarisë investigative dhe analitike nëpërmjet inovacionit në krijimin e përmbajtjes dhe qasjes së audiencës, dhe nëpërmjet rritjes së besimit të qytetarëve tek mediat si roje të vlerave demokratike, inkurajimit të mediave të pavarura dhe të lira, si dhe krijimit të një mjedisi të favorshëm për punën dhe zhvillimin e medias së pavarur, si një nga shenjat themelore të një shoqërie demokratike.

Si projekte dhe aktivitete që do të mbështeten nga donacioni janë historitë investigative multimediale, të cilat synojnë të maksimizojnë ndikimin duke kombinuar forma inovative, teknologji dhe përmbajtje për të treguar një histori, duke i ofruar audiencës një përvojë të ndryshme të zbulimit dhe të kuptuarit të problemeve që lidhen me korrupsionin dhe sundimin e të drejtës. Sa më sipër, në drejtimin që hulumtimi cilësor dhe i pavarur i thënë në mënyrë inovative i motivon qytetarët të kenë raportim të pavarur, si një e mirë publike, gjë që çon në rritjen e besimit në media dhe përmirësimin e arsimit mediatic në vend. Me ndihmën e këtij donacioni, LRI Shkup do të zbatojë modelin inovativ të tregut multimedial për të raportuar për tema që janë të rëndësishme për qytetarët dhe që do t'i ndihmojnë ata të marrin vendime të informuara - propagandë politike gjatë zgjedhjeve dhe sundimi i së drejtës. Gjithashtu, raportimi i LRI-së Shkup në periudhën parazgjedhore do të fokusohet në kontrollimin e fakteve që kandidatët politikë i paraqesin gjatë kohës së paraqitjeve publike, paraqitjeve në debate, diskutimeve publike dhe debateve. Duke pasur parasysh se sipas Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2023 - situata në gjyqësor(jurispodencë) është shqetësuese dhe nuk është vërejtur progres në realizimin e reformave të kërkuara nga vendi si pjesë e proceseve integruese evropiane, pranuesi (përfituesi) i donacionit do t'i përkushtohet mapës (hartës) së gjyqtarëve, prokurorëve dhe avokatëve që kanë lidhje me strukturat politike dhe komunitetin e biznesit, nëpërmjet tekstit, dhe përmes përmbajtjes tekstuale, audio dhe audiovizuale. Raportimi do të fokusohet në konfliktet e mundshme të interesit që rrjedhin nga lidhjet personale të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe qytetarët do të marrin informacionin e vërtetë (duhur) për ata që hetojnë, ndjekin penalisht dhe gjykojnë në emër të tyre. Në të njëjtën kohë, donacioni do të sigurojë rritje të vëllimit dhe cilësisë së përmbajtjes së prodhuar nga LRI Shkup, fokusi i së cilës janë prioritetet strategjike të shtetit, si lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër dezinformimit, mbështetje për punën e LRI-së Shkup për të përmirësuar tregun e mediave dhe krijimin e kadrove shtesë që do të prodhojnë përmbajtje sipas standardeve më të larta profesionale ndërkombëtare. Produktet e prodhuara në kuadër të këtij donacioni do të jenë pjesë e aktiviteteve tashmë të nisura që mbështesin qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretërisë së Holandës dhe Shërbimit Publik.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15, dhe në lidhje me nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 18 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nenet 4, 6, 7, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për donacion dhe sponsorizim në veprimtari publike, neni 39 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 15 dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 17 të Rregullores së punës së Agjencisë dhe Konkluzioni i Këshillit të Agjencisë, ark.nr.0201-234/2 datë 15.1.2024, Drejtori i Agjencisë ka marrë vendim për dhënien e ndihmës financiare - donacion për Shoqatën e qytetarëve LABORATORI I RAPORTIMIT INVESTIGATIV - LRI Shkup në shumë prej 5.000.000,00 (pesë milionë) denarë. Sipas këtij vendimi, LRI Shkup detyrohet që mjetet e dhëna financiare t'i shfrytëzojë ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në pikën 1 paragrafi (1) të

tij. Mjetet financiare të dhëna nga pika 1 e këtij vendimi janë të parapara në Planin financiar të Agjencisë për vitin 2024 dhe pagesa do të kryhet në llogarinë e LRI Shkup: 300-0000041683-20, depozitues i Bankës Komerciale SHA Shkup, me numër tatimor 4032018536475. Për dhënien e ndihmës financiare në fjalë, lidhet kontratë për donacion ndërmjet Agjencisë dhe LRI Shkup, e cila hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët kontraktuese dhe do të zbatohet pas marrjes së mendimit pozitiv për interesin publik nga Ministria e Drejtësisë e RMV- së .

Ky Vendim hyn në fuqi me miratimin e tij dhe do të publikohet në ueb-faqen e Agjencisë .

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Drejtori,**

Dr. Zoran TRAJÇEVSKI